

VENDIM
I ASAMBLESE SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
WVP FUND MANAGEMENT TIRANA SH.A

Sot më datë 29.04.2019 në orën 16:00 në zyrën e WVP Fund Management Tirana sh.a, Rr. Barrikadave Nr. 118/4/1, Tiranë, Shqipëri, u mbajt Mbledhja e Asamblesë së aksionarëve të shoqërisë WVP Fund Management Tirana sh.a.

Janë të pranishëm

- WVP Fund Management AD Shkup, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin maqedonas, me nr të regjistrimit tregtar 6938120, me seli ne Vasil Glavinov, nr.14-1/8 Shkup, Qender, përfaqshuar nga Z. Arton Lena, zotëron [51%] (pesëdhjetë e një përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 6,630 aksione.
- WVP-Ndërmjetësim në Sigurime sh.a Tirana, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin shqiptar, me nr të regjistrimit tregtar K62324003M, me seli Rruga Barrikadave, Nderresa 18 H.6 Ap.11,Tiranë, përfaqshuar nga Z. Ardian Kelemendi, zotëron [25%] (njëzet e pesë përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 3,250 aksione.
- Z. Arton Lena shtetas austriak, lindur më 27.09.1984, me nr. Pasaporte U0575839, njohës i gjuhës shqipe, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit, drejtues i mbledhjes. Zotëron [12.31%] (dymbëdhjetë pikë tridhjetë e një përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 1600 aksione.
- Z.Rupert Strobl shtetas austriak, lindur më 30.08.1954, me nr. pasaporte U0349316, njohës i gjuhës angleze dhe shqipe nivel elementar, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Administrimit. Zotëron [4%] ([katër përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 520 aksione.
- Z.Kujtim Ibraimi, shtetas maqedonas lindur më 29.08.1975, në Kërçovë, Maqedoni dhe banues në fshatin Kolibare, Kërçove me nr pasaporte G0199597, njohës i gjuhës shqipe, në cilësinë e aksionarit që zotëron [4.19%] ([katër pike nëntëmbëdhjetë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë ose 545 aksione.
- Z.Ardian Kelmendi, shtetas austriak, lindur më 23.03.1972, me nr. pasaporte P5759099, njohës i gjuhës shqipe, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit. Zotëron [2.5%] (dy pikë pesë përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë ose 325 aksione.
- Z.Ogjen Tilikj, shtetas maqedonas, lindur më 11.05.1986, me nr. pasaporte C0039741, njohës i gjuhës maqedonase dhe shqipe nivel elementar, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit. Zotëron [1%] (një përqind) të aksioneve të kapitali të shoqërisë ose 130 aksione.

Kryetari deklaron se mbledhja e Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë është thirrur rregullisht. Ai deklaron se aksionarët e shoqërisë janë njoftuar nga Administratori i Përgjithshëm për zhvillimin e mbledhjes së aksionerëve, nëpërmjet një njoftimi me postë elektronike në datën 25.03.2019 ora 17:25 duke respektuar procedurat dhe afatet e kërkuara nga Statuti i Shoqërisë për zhvillimin e mbledhjes së aksionarëve. Aksionerët e shoqërisë janë të pranishëm.

Drejtuesi i mbledhjes deklaroi se mbledhja është thirrur konform dispozitave të statutit të shoqërisë dhe si rrjedhojë është e vlefshme dhe e ligjshme për të marrë vendime pasi janë të pranishëm të gjithë aksionarët e shoqërisë. Drejtuesi i mbledhjes deklaroi se mbledhja është thirrur me qëllim për të diskutuar dhe vendosur mbi Rendin e Ditës si më poshtë vijon:

Rendi i ditës

1. Miratimi i pasqyrave financiare të audituara për vitin 2018 për Shoqërinë WVP Fund Management Tirana Sh.A.
2. Miratimi i pasqyrave financiare të audituara për vitin 2018 për Fondin WVP Top Invest.
3. Zgjedhja e Ekspertit Kontabël të Shoqërisë dhe Fondit WVP Top Invest për vitin 2019
4. Të ndryshme

Pasi konstaton

Praninë e 100% të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë Drejtuesi i Mbledhjes

Deklaron

Mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë (në vijim referuar si "Asambleja") të mbledhur rregullisht dhe të aftë për të diskutuar dhe vendosur në mënyrë të vlefshme mbi Rendin e Ditës.

1. MIRATIMI I PASQYRAVE FINANCIARE TË AUDITUARA PËR VITIN 2018 PËR SHOQËRINË WVP FUND MANAGEMENT TIRANA SH.A

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës Drejtuesi i mbledhjes informon asamblenë se në bazë të rezultatit financiar të shoqërisë të arritur gjatë vitit 2018 rezultoi se shoqëria ka gjeneruar një humbje neto prej 1,531,844.00 lekë të llogaritura këto në përputhje me ligjin për kontabilitetin e pasqyrave në tabelat financiare të shoqërisë për vitin 2018. Drejtuesi i mbledhjes propozon që shuma e sipërpërmendur e humbjes neto për vitin 2018 të mbartet në vitin pasardhës.

Për këtë qëllim Drejtuesi i Mbledhjes I propozon Asamblesë miratimin e këtij vendimi. Pasi u njoh me pikën e parë të Rendit të Ditës, Asambleja në unanimitet

Vendos

Miratimin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2018 për Shoqërinë WVP Fund Management Tirana sh.a

Miratimin e rezultatit financiar me humbje me vlerën 1,531,844.00 lekë.

2. MIRATIMI I PASQYRAVE FINANCIARE TË AUDITUARA PËR VITIN 2018 PËR FONDIN WVP TOP INVEST

Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës Drejtuesi i mbledhjes informon asamblenë se në bazë të rezultatit financiar të fondit të arritur gjatë vitit 2018 rezultoi se fondi ka gjeneruar një humbje neto prej 268,168.92 lekë të llogaritura këto në përputhje me ligjin për kontabilitetin e pasqyrave në tabelat financiare të fondit për vitin 2018. Drejtuesi i mbledhjes propozon që shuma e sipërpërmendur e humbjes neto për vitin 2018 të mbartet në vitin pasardhës.

Për këtë qëllim Drejtuesi i Mbledhjes i propozon Asamblesë miratimin e këtij vendimi. Pasi u njoh me pikën e parë të Rendit të Ditës, Asambleja në unanimitet

Vendos

Miratimin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2018 për Fondin WVP Top Invest

Miratimin e rezultatit financiare me humbje me vleren 268,168.92 lekë.

3. ZGJEDHJA E AUDITUESIT TË JASHTËM TË SHOQËRISË DHE FONDIT WVP TOP INVEST PËR VITIN 2019

Në lidhje me pikën e tretë të Rendit të Ditës, Drejtuesi i Mbledhjes propozon që Audituesi i jashtëm i Shoqërisë dhe Fondit të jetë Grant Thornton me adresë, Rr.Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D, Shk. B, Floor 1,1000 Tirana, Albania.

Për këtë qëllim Drejtuesi i Mbledhjes I propozon Asamblesë miratimin e këtij vendimi. Pasi u njoh me pikën e tretë të Rendit të Ditës, Asambleja ne unanimitet

Vendos

Miratimin si auditues të jashtëm të shoqërisë dhe fondit për vitin 2019 Grant Thornton sh.p.k.

Duke qënë se nuk ka çështje të tjera për tu diskutuar dhe askush nuk e kërkon fjalën, Drejtuesi i Mbledhjes e deklaroi Mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë të mbyllur ne orën 17:00.

Rupert Strobl

Arton Lena

Ardian Kelmendi

Kujtim Ibraimi

Ogner Tilikj

WVP – Ndermjetësim ne sigurime sh.p.k

WVP Fund Management AD Shkup

